



UNMIK/REG/2005/38
29 korrik 2005

RREGULLORE NR. 2005/38

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2005/2 MBI
THEMELIMIN E KOMISIONIT TË PAVARUR PËR MINIERAT DHE
MINERALET**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Në pajtim me nenin 8.1 (q) dhe (r) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001) dhe pas konsultimit me Qeverinë,

Pas shpalljes së Rregullore së UNMIK-ut nr. 2005/2 të datës 21 janar 2005 mbi themelimin e Komisionit të pavarur për minierat dhe mineralet,

Me qëllim të përcaktimit të udhëheqësisë së Komisionit të pavarur për minierat dhe mineralet gjatë periudhës fillestare pas themelimit,

Me anë të kësaj shpall ndryshimet vijuese në nenin 3 të Rregullore së UNMIK-ut nr. 2005/2:

Neni 1
Ndryshimet

Nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje,

A. Neni 3.2 i Rregullore së UNMIK-ut nr. 2005/2 ndryshohet në nënnenin (a) duke fshirë “,duke përfshirë kryesuesin,” nga ky nënnen.

B. Neni 3.3 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/2 ndryshohet në nëninin (a) duke fshirë fjalët “kryesuesi dhe një” dhe duke i zëvendësuar me fjalën “dy”. Sëkëndejmi nënini (a) është si vijon:

“(a) Dy (2) vite për dy anëtarët tjerë të emëruar në pajtim me nenin 3.2 a;”

C. Shtohet një nen i ri 3.4 me këtë formulim:

“3.4 Njëri prej anëtarëve të emëruar në pajtim me nenin 3.2 a do të caktohet kryesues nga PSSP-ja për një periudhë gjashtëmujore. Mëpastaj, këtë pozitë e mban anëtari i emëruar në pajtim me nenin 3.2 b”

dhe nenet vijuese rinumërohen në përputhje me këto ndryshime.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 29 korrik 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm